

N j o f t i m P u b l i k

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05nr.351/02-102396/26 dt.09.07.2026, në emër të pronarit Rrahim Bajrami nga Prishtina përmes së cilës kërkohet të caktohen kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor për ndërtimin e shtëpisë individuale të banimit me etazhitet P+1 në kuadër të PZHU-se, konkretisht parcelave kadastrale nr. 1104-8 ZK Prishtinë.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data **03.09.2026** deri më **07.09.2026**, në E-mail adresën: urbanizmpirishtine@rks-gov.net

Kushtet e propozuara të ndërtimit	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Shtëpi individuale të banimit me etazhitet P+1
b. Vija rregulluese	Sipas projektit konceptual
c. Vija ndërtimore	3.00m' – 5.00m' nga vija rregulluese
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	~ 8.24m'
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor dhe të pasmë të parcelës kadastrale	~8.24m' / 1.15 – 2.27m', anësore djathtas ~8.24m' / 4.37 – 4.80m', anësore majtas ~8.24m' / 1.80 m', e pasme /
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHP=30%
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHGJ=40%
h. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISPN=0.6-0.8
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHPN=30 %
j. Numri i hapësirave për vend parkime të automjeteve në kuadër të parcelës	Minimum 1-VP për një njësi banimi
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja	Fasadë termike dhe ventiluese
m. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po ☒ Jo ☐ Nuk aplikohet ☐	
n. shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë me të madhe se sa zona për rreth? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	
o. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 06/2017, dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet që përcillen në adresën elektronike, të shënuar më lartë, të përshkruhet edhe numri i kërkesës, i shënuar në paragrafin 1 të këtij njoftimi publik.

Zyrtari: _____

